



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 8.2.2023

Nr: 44

Ora: 13:00

V E N D I M

P Ë R

**MIRATIMIN E PROCEDURAVE OPERACIONALE PËR SHKATËRRIMIN E TË DHËNAVE NË PAJISJEN
ELEKTRONIKE TË IDENTIFIKIMIT (PEI) DHE SISTEMIN ELEKTRONIK TË IDENTIFIKIMIT TË
VOTUESVE (SEIV)**

Në mbështetje të nenit 14, nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, dhe nenit 178, pika 6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, të udhëzimit nr. 14, datë 22.12.2011, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Për përpunimin, mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në sektorin e komunikimit elektronik të publikut”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve,

V E N D O S I N:

1. Gjashtë muaj pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, të dhënat në pajisjen elektronike të identifikimit (PEI) në memorien e brendshme e USB, dhe në sistemin elektronik të identifikimit të votuesve (SEIV), të përdorura për identifikimin elektronik të zgjedhësve, shkatërrohen me urdhër të përbashkët të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, sipas procedurave të miratuara në këtë vendim.
2. Miratimin e procedurave operacionale për shkatërrimin e të dhënave në pajisjen elektronike të identifikimit (PEI) në memorien e brendshme e USB, dhe në sistemin elektronik të identifikimit të votuesve (SEIV) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të përdorura për identifikimin elektronik të zgjedhësve, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Dokumentet e printuara nga pajisjet elektronike të identifikimit me të dhëna sensitive të zgjedhësve që ndodhen në kutitë e materialeve zgjedhore do të asgjësohen sipas nenit 178, pika 6, të Kodit Zgjedhor. Dokumentet e hapjes dhe mbylljes së procesit të votimit

Data: 8.2.2023 Nr:44
Ora:13.00



“Për miratimin e procedurave operacionale për shkatërrimin e të dhënave personale në pajisjen elektronike të identifikimit (PEI) dhe sistemin elektronik të identifikimit të votuesve (SEIV)”

që kanë printuar pajisjet PEI të dërgohen në Arkivin Qendror të Shtetit së bashku me dokumentacionit zgjedhor të përcaktuar në nenin 178, pika 6 të Kodit Zgjedhor.

4. Të dhënat biometrike për të cilat nga procesi i kryqëzimit të të dhënave ka rezultuar votim i shumëfishtë dhe është bërë kallëzim penal në organet përkatëse, të ruhen deri në përfundim të hetimit.
5. Komisioni i ngarkuar për asgjësimin e të dhënave ngrihet me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së.
6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe komisioni i ngritur sipas pikës 5 të këtij vendimi, për zbatimin e tij.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Lealba PELINKU

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Lidhja nr. 1

PROCEDURA OPERACIONALE PËR SHKATËRRIMIN E TË DHËNAVE NË PAJISJET ELEKTRONIKE TË IDENTIFIKIMIT (PEI) DHE SISTEMIN ELEKTRONIK TË IDENTIFIKIMIT TË VOTUESVE (SEIV)

Të dhënat personale që disponon KQZ për zhvillimin e zgjedhjeve si dhe të dhënat biometrike të mbledhura gjatë ditës së zgjedhjeve janë të ruajtura në:

1. Pajisjen e identifikimit elektronik PEI
 - a. Memoria e brendshme
 - b. USB
2. Serverat e bazave të të dhënave në datacenter primar dhe sekondar

Hapat që do të ndiqen për shkatërrimin e materialeve elektronike pajisjeve të identifikimit elektronik PEI

1. Çdo pajisje PEI do të kthehet në gjendje fabrike duke ndjekur procedurën e *reset* të pajisjeve elektronike me sistem operimi *Android* si më poshtë: Rregullime/Sistemi/Opsionet e mirëmbajtjes/spastro të gjitha të dhënat (rivendosja e fabrikës)/ shtyp Rivendos pajisje.
2. Të gjitha memorieve USB të prodhuara gjatë zgjedhjeve do t'u fshihet informacion në mënyrë të përhershme nëpërmjet procesit të formatimit.
3. Serverat të cilët mbajnë rezultatet e identifikimit elektronik dot t'ju fshihen të dhënat e bazës së të dhënave në mënyrë të pakthyeshme, duke përdorur mjetet e ofruara nga baza e të dhënave.

I gjithë procesi i shkatërrimit të të dhënave elektronike dhe fizike do të monitorohet nga minimumi 3 punonjës të caktuar në grup pune për këtë qëllim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Grupi i punës në fund të procedurës do të dorëzojë procesverbalin ku konfirmon fshirjen e të dhënave elektronike dhe shkatërrimin e materialeve fizike sipas hapave të sipërpërmendur.